



Qielli dhe Toka: Një perspektivë shpirtërore

Description

Sachiko Murata & William Chittick

Fragment i shkëputur nga libri i autorëve Sachiko Murata & William Chittick me titull: "The Vision of Islam", I. B. Tauris, New York 2000

Një tjetër çift termash kuranorë që përdoren zakonisht gjatë diskutimit të universit, janë *qielli* edhe *toka*.

Gjatë diskutimit për qiellin është e rëndësishme që të mos ta ngatërrojmë atë me Parajsën. Në islam para jua shkon gjithnjë çift me fjalën Ferr, ndërsa qielli është gjithnjë në çift me tokën.

Parajsa dhe Ferri i përkasin rikthimit tek Zoti. Ato nuk mund të përjetohen në plotësinë e tyre deri në ditën e gjykimit. Ndërsa qielli dhe toka i referohen situatës së kozmosit që nga fillimi i krijimit deri në ditën e Gjykimit, sepse në Ditën e Gjykimit qielli dhe toka do të transformohen: "*Dita kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt në tjetër qiej, e njerëzit të dalin të gjithë para Allahut, të Vetmit, Mbizotëruesit*" (Ibrahim 48).

Kurani shpesh herë i referohet shtatë qiejve e shtatë tokave. Është e rëndësishme të mos ti mendojmë, këto shtatë qiej e toka nën termat e astronomisë moderne. Ndonëse myslimanët kanë krijuar ndër shekuj një astronomi të zhvilluar, prapëseprapë astronomia kuranore është astronomia e ajeteve. Ajo çfarë ne shohim me sytë tanë është përdorur nga kurani si mjet për të na rrëfyer të panjohurën-Zotin, engjëjt, botën tjetër etj. Kështu që, diskutimi kuranor lidhur me qiejt është kufizuar në atë që çdokush nga ne mund të shohë me sy të zhveshur duke dalë thjesht tek ballkoni i shtëpisë së tij.

Është e nevojshme të ngulisim në mend se qiejt janë gjithnjë të mbushur me domethënie për njerëzit që jetojnë në kontakt me natyrën, larg ndotjes atmosferike e ndërhyrjes së ndriçimit të qyteteve.

Në botën moderne, dija shkencore na ka shkëputur nga përjetimi i drejtpërdrejtë i natyrës. Ne e kemi humbur luksin që ti shohim gjërat ashtu siç na shfaqen ato në natyrë. Përkundrazi, ne i shohim gjërat ashtu siç na mësojnë në 8 vjeçare apo në gjimnaz sesi ato janë. Jo vetëm kaq, por në shumicën e rasteve ne nuk kemi asnjë interes ti shohim vetë gjërat sepse mendojmë se shkencëtarët, specialistët,

njohin gjithçka dhe ne nuk mund të zbulojmë asgjë me rëndësi për vetet tona nëse e vëzhgojmë natyrën personalisht. Nëse ne kemi nevojë të njohim diçka, ne shpresojmë ta gjejmë në një libër.

Neve na duket më e rëndësishme dhe më dinamike drita elektronike e valëve të televizionit sesa drita e yjeve të cilët duken kaq të palëvizshëm. Meqë ra fjala, por çfarë bëjnë njerëzit çdo natë para televizorit xhanëm?

Së paku në një ajet kuranor qiejt dhe toka bashkëngjiten me Kursijun e Zotit. Në ajetin e famshëm kursij lexojmë: *“Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. As gjumi e as lodhja nuk e mbërrin Atë, e gjithçka që ka në qiej e në tokë është vetëm e tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek ai përveç atij që i jep leje Ai? Ai e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen. Nga ajo që Ai di të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar. Kursija e tij përfshinë qiejt e tokën, kujdesi për to nuk i vjen rëndë atij, Ai është më i larti më i madhi.* (Bekare 254).

Ajo që duhet vënë re në këtë ajet është fakti që Allahu ndonëse përmend qiejt dhe tokën nuk është duke folur për universin por për Atributet e Tij. Nga ajeti i lartpërmendur kuptojmë se Zoti njuh gjithçka, ndërsa njerëzit njohin aq sa Zoti i ka lejuar të njohin. Me fjalë të tjera njohja e jonë është e kufizuar, ndërsa njohja e Zotit për universin është e pakufizuar. Më pas ajeti përmend universin, qiejt dhe tokën kalimthi. Në të përmendet një fakt shumë i rëndësishëm që Kursiju i tij përfshin qiejt dhe tokën. Kursiju është vendqëndrimi i këmbëve të Zotit. Nëse këmbët e Zotit janë përtej universit atëherë ku mund të ndodhet “koka” e Tij. Jo se Zoti zotëron kokë apo këmbë sipas asaj që njohim ne por imazhi i kursit, është një imazh shumë i fortë që sugjeron ndërveprim.

E ky ka të bëjë me faktin se ajo që është më e ulët tek Zoti qëndron përtej asaj që është më e lartë në univers. Zoti nevojitet që të zbresë poshtë në mënyrë që të ndërveprojë me krijesat e tij, ndërsa ne duhet të ngrihemi shumë lart për ta gjetur atë.

Kursiju është i vendosur poshtë Arshit të Zotit, vendit ku zoti Mbret, qëndroi pasi krijoi qiejt dhe tokën. Kurani e përmend Arshin mëse 21 herë, në të gjitha e bën këtë për të potencuar mbretërimin e Zotit dhe fuqinë e tij. Megjithatë, ndoshta për të kompensuar ngjyrimet e madhështisë dhe mërisë së Mbretërimin të tij, kurani i asocion këtyre ajeteve vetëm një emër hyjnorë, dhe ai është i Mëshirshmi.

Zoti nuk është i ngjashëm me mbretërit e tjerë, atributet primare të të cilëve janë madhështia dhe mëria. Përkundrazi Zoti është një Mbret mëshira e të cilit e ka tejkaluar Mërinë e tij. Mos harroni atë që thamë në ligjëratën e kaluar, në Arshin e Zotit është shkruar: *“Mëshira ime ka përparësi ndaj Zemërimit tim”* Pra ideja e Arshit hyjnorë i kombinon atributet e madhështisë dhe të bukurisë.

Dhe ky është kombinimi i duhur për diçka që ka përfshirë qiejt dhe tokën, duke qenë se Universi udhëhiqet nga të dy këto lloje atributesh.

Një tjetër vend ku mund të kuptojmë diçka në lidhje me qiellin dhe Tokën është edhe hadithi i natës së Miraxhit. Hadithi është si vijon: Pejgamberi rrëfen: Isha në Mekë kur pëlciti (në shumë vende) tavani i dhomës, zbriti Xhebraili, ma hapi gjoksin e ma lau me ujë zemzemi, e solli legenin e artë, të mbushur me urtësi dhe besim dhe e derdhi në gjoksin tim, pastaj e bashkoi, më mori për dore dhe më ngriti tek

qielli i kësaj bote. Kur ka ardhur tek qielli më i afërt, Xhebraili i tha rojtari: “Hape!

“Kush është? –pyeti (rojtari).

-Xhebraili- u përgjigj ai.

– A është dikush me ty?- pyeti rojtari.

-Po, – tha Xhebraili,- me mua është Muhamedi (a.s).

-Atij që i është dërguar peygamberia?- pyeti rojtari.

-Po- u përgjigj Xhebraili.

Kur e hapi, u ngritën deri tek qielli më i afërt e atje rrinte ulur një njeri, kurse në të djathtë dhe në të majtë të tij, grupe njerëzish; kur shikon kah ana e tij e djathtë, qeshet e kur shikon nga ana e majtë, qan.

Mirë se ke ardhur peygamber i mirë dhe njeri i mirë- tha.

-Kush është ky?- e pyeta Xhebrailin.

-Ky është Ademi (peygamberi)- tha ai, -e të gjitha masat nga ana e tij e djathtë dhe e majtë janë pasardhësit e djemve të tij; ata në anën e djathtë janë banorët e Xhenetit, kurse masat që janë në anën e majtë të tij, janë banorët e Xhehenemit; prandaj kur shikoi në të djathtë, qeshi, e kur shikoi në të majtë, qau.

Kur më ngriti (Xhebraili) në qiellin tjetër, i tha rojtari të tij: “Hape!” Edhe rojtari i këtij qielli pyeti njëlloj si dhe ai i pari dhe pastaj e hapi.

Enesi ka thënë, se Ebu Dherri ka përmendur, se Muhamedi (a.s) në qiej ka gjetur: Ademin, Idrisin, Musain, Isain dhe Ibrahimin (paqja qoftë mbi ta) e nuk ka saktësuar se çfarë janë pozitat e tyre, pos që ka përmendur se Ademin e ka gjetur në qiellin më të afërm e Ibrahimin në qiellin e gjashtë.

Kur Xhibrili me Peygamberin (a.s) kanë kaluar pranë Idrisit (a.s), ai e ka përshëndetur me fjalët: “Mirëse ke ardhur Peygamber i mirë dhe vëlla i mirë.”

– Kush është ky?- pyeta.

– Ky është Idrisi- iu përgjigj Xhebraili.

Pastaj kam kaluar pranë Musait a.s dhe ai më tha: “Mirë se ke ardhur Peygamber i mirë dhe vëlla i mirë.”

– Kush është ky?- pyeta.

– Ky është Musai- tha Xhebraili.

Pastaj kam kaluar pranë Isait dhe ai më tha: “Mirë se ke ardhur vëlla i mirë dhe Peygamber i mirë.”

– Kush është ky?- pyeta.

– Ky është Isai- u përgjigj Xhebraili.

Pastaj kam kaluar pranë Ibrahimit e ai më tha: “Mirë se ke ardhur Pejgamber i mirë e bir i njeriut të mirë.”

– Kush është ky?- pyeta.

– Ky është Ibrahim i a.s.

Ibni Shehibi, thotë se e ka njoftuar ibn Hazmi se Ibn Abbasi dhe Ebu Habbe Ensariu ka thënë që Pejgamberi a.s ka thënë: ” Xhebraili më ka çuar edhe më tutje, derisa u gjenda në një hapësirë të pakufi, në të cilën kam dëgjuar fërshëllimën e penave.”

Ibn Hazmi dhe Enes bin Maliku thotë se Pejgamberi a.s ka thënë: “Allahu ymetit tim ia ka caktuar 50 namaze në ditë. Unë me këtë jam kthyer dhe kur kam kaluar pranë Musait a.s e ai më tha: ‘Çfarë i obligoi Allahu ymetit tënd?’

I obligoi 50 namaze-iu përgjigja.

-Kthehu te Zoti yt!-tha Musai- ngase ymeti yt nuk do të mund ta përballojë këtë.

Kjo më shtyu të kthehem dhe Allahu e zvogëloi një pjesë. Pastaj u ktheva tek Musai dhe i thashë: “Ma zvogëloi një pjesë.”

– Kthehu prapë tek Zoti yt!- tha ai- ngase meti yt as këtë nuk mund ta përballojë.

U ktheva tek Zoti dhe Ai prapë ma zvogëloi një pjesë. Pastaj u ktheva tek Musai dhe Ai më tha: “Kthehu tek Zoti yt se ymeti yt se as këtë nuk do të mund ta përballojë!”

Prapë u ktheva tek Zoti im e Ai më tha: “Ato janë pesë e llogariten pesëdhjetë, ngase fjala tek Unë nuk ndërron.” Pastaj jam kthyer tek Musai e ai më tha: “Kthehu prapë tek Zoti yt” dhe unë i thashë: “Turpërohem nga Zoti im.”

Pastaj Xhebraili më çoi më tutje derisa më shpiu në Sidretu-l-Munteha të cilën e kishin mbuluar ngjyra të ndryshme e që nuk i di çfarë llojesh. Pas kësaj jam futur në Xhenet e në të kishte kupola prej xhevahiri e dheu i tij mbante erë parfum.”

Nga hadithi i mësipërm kuptojmë se konceptet kuranor për qiejt dhe tokën nuk kanë të bëjnë domosdoshmërisht me planetët e yjet.

Shumë prej dijetarëve myslimanë kanë pohuar se në këtë hadith ka simbolika domethënëse. Sipas

tyre në këtë hadith qiejt përfaqësojnë nivelet e ekzistencës dhe faktin se çdo nivel përfaqëson attribute të ndryshme hyjnore. Gjithsecili prej profetëve që Muhamedi takoi natën e Miraxhit, përfaqësojnë pjesë së tërësisë së mesazhit hyjnorë, ose më mirë një segment të totalitetit të shenjave që Zoti ka shfaqur në kozmos e në shkrimet e shenjta. Asnjë prej myslimanëve, kur ka analizuar fjalën qiej në këtë hadith, nuk ka besuar se Ademi, Musa, Ibrahim, apo profetët e tjerë që Muhamedi takoi atë natë jetojnë në planetë, ose së paku jo në planetë siç jemi mësuar ti njohim nga astronomia e sotme.

Për myslimanët yjet që shkëlqejnë në qiej janë shenja të Zotit që e mbushin ekzistencën me dritën e mesazhit hyjnorë. Ato janë shenja që i dërgojnë të gjithë ata të cilët dëshirojnë të takojnë Zotin në nivele të larta të ekzistencës.

Kur diskutohet koncepti i qiellit dhe i tokës sipas përdorimit kuranor, çështja bazë ka të bëjë me natyrën e marrëdhënies që ekziston ndërmjet krijesave, ose hierarkinë që është vendosur në univers si rezultat i nënshtrimit që i ka bërë universi Zotit.

Ne arrijmë ti kuptojmë marrëdhëniet ndërmjet Zotit dhe Krijimit duke përdorur tenzihun dhe Teshbihun.

Në të njëjtën mënyrë ne mund të kuptojmë edhe marrëdhënien që ekzistojnë ndërmjet krijesave të Zotit, duke e marrë qiejt edhe tokën si miniaturë e marrëdhënieve Zot-krijim.

Kur dijetarët i shohin qiejt dhe tokën nën këndvështrimin e pakrahasueshmërisë (Tenzihut), ato i përshkruajnë qiejt dhe tokën si dy të kundërta. I lartë dhe i ulët, dritë dhe errësirë, i fuqishëm dhe i dobët, aktivë dhe pasivë, dhënës dhe marrës.

Kur dijetarët myslimanë e shohin marrëdhënien e qiejve dhe të tokës nga këndvështrimi i ngjashmërisë (Teshbihut), ato pohojnë se cilësitë e qiejve gjenden edhe në tokë, vetëm se në mënyrë të zbehtë.

Qiejt janë vendi primarë ku atributet e krijimit të Zotit shfaqen. Në të kundërt cilësitë e tokës varen nga pranimi që ajo i bën qiellit. Edhe qielli nga ana e tij varet nga toka sepse pa tokën, qielli nuk do të kishte vend për të shpalosur artin e tij, ajetet e tij. (Teuhidi)

Qiejt përfaqësojnë një fuqi të përqendruar, të padiferencuar dhe jomateriale, ndërsa toka përfaqëson një përmbledhje shenjash, të shpërndara, të diferencuara, dhe materiale, të afta ta bëjnë të dukshme fuqinë e padukshme të qiellit.

Simboli bazë që përdor Kurani për qiellin është uji, i cili është i pastër dhe i padiferencuar. Kur uji i qiellit bie në tokë i jep jetë një pafundësie të ndryshme krijesash. Ashtu siç thuhet edhe në kuran: “*Dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi*” (Enbija 30).

Shumë dijetarë myslimanë pohojnë se ky verset nuk i referohet vetëm jetës bimore dhe kafshërore por gjithçkaje të krijuar, duke qenë se gjithçka që është në qiej e në tokë dëshmon falënderim ndaj Zotit siç shprehet shpesh edhe kurani. Si mundet përndryshe diçka të dëshmojë nëse nuk është e gjallë?

Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxori bimën e çdo sendi... (Enam 99)

E ti e sheh tokën e thatë-të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme. (Haxh 5)

Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër. Që me të t'i japim jetë një toke të vdekur... (Furkan 48)

Nëse uji i qiellit është i pastër, ai gjithashtu është edhe “një”, sepse është i padiferencuar siç thamë. Vetëm pasi është pirë nga toka ai i jep jetë diversitetit, pra bëhet i diferencuar.

“E në tokë, copa sipërfaqesh, te ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të llojlojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njërin prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur. (Rrad 48).

Toka, pra, është vendi ku qielli pasqyron të gjitha cilësitë e tij, ashtu siç qielli dhe toka së bashku (kozmosi) pasqyron shenjat e Zotit.

Qielli është afër Zotit, toka është larg tij. Duke qenë afër Zotit qielli na rrëfen atributet e teshbihut, ndërsa toka është e dominuar nga atributet e Tenzihut.

Megjithatë, për sa kohë edhe toka shfaq elemente të pjellorisë, bollëkut e bereqetit, do të thotë se ajo shfaq cilësitë e bukurisë dhe të mëshirës së Zotit, kështu që edhe toka mund të shihet nga perspektiva e Teshbihut. Edhe qielli nuk është i përjashtuar nga Tenzihu duke qenë se: *“Gjithçka do të shkatërrohet përveç fytyrës së Zotit” (Kasas 88)*, e ky ajet përfshin edhe qiellin.

Përktheu: Rezart Beka

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi